



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Kuvendi i Komunës Klinë

Debat me Publikun

01 Nr. 06 - 16458 /24

Klinë, dt: 17.05 /24

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Debatit me Publikun, mbajtur, më 08.04.2024, me fillim nga ora 13:30 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi drejtori i Administratës, z.Binak Sylaj, i cili përshëndeti nënkryetaren, znj. Marqe Tanushi-Selmanaj, zyrtaren për Barazi Gjinore dhe gjithë të pranishmit.

RENDI I DITËS

DRAFT- STRATEGJIA KOMUNALE DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE 2024 – 2027.

Binak Sylaj, drejtor i Administratës: Në radhë të parë faleminderit që ju keni përgjigjur ftesës për debat me publikun, rreth një drafti që është i hartuar nga institucioni komunal në bashkëpunim me gjitha institucionet tjera. Përshëndetje për nënkryetaren e komunës, zyrtaren për Barazi Gjinore dhe gjithë të pranishmit!

Mendoj që është ndër draft strategjitë më të rëndësishme komunale dhe ky draft hartohet një herë në tri vite. Drafti ka të bëjë kundër dhunës në familje, është për vitin 2024 - 2027 dhe është hartuar nga një grup ekspertësh nga komuna. Meritë kryesore e këtij organizimi dhe e kësaj pune është zyrtarja për Barazi Gjinore, znj. Vitore Shala e cila ka koordinuar punën. Unë pavarësisht se kam qenë kryesues i këtij komisioni mbi të gjitha barra dhe puna kanë mbetur në zyrtaren për Barazi Gjinore.

Vetë titulli Draft Strategji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje është një dokument i rëndësishëm

që edhe komuna e Klinës duhet patjetër që jo vetëm ta hartojë, por të angazhoheni gjitha institucionet relevante, që në ditët në vijim ky draft që është i prezantuar këtu ta merr pëlqimin edhe nga ju. Do t'i inkorporojmë edhe të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet e juaja, për arsye se kohëve të fundit këto dukuri janë shumë të shpeshta në nivel të vendit. Po ashtu, edhe komuna jonë ka probleme të llojeve të ndryshme, nuk flasim vetëm për një gjini por për krejt; dhunë në familje nënkupton dhunë të llojllojshme, si dhunë fizike, psikologjike, dhunë në familjet tona që janë të shpeshta. Ato çka e shkaktojnë këtë dhunë janë disa faktorë që janë të përfshirë në këtë draft, mendoj që një ndër faktorët kyç edhe relevant është faktori ekonomik, faktori social, faktorët tjerë që i përkasin shoqërisë tonë që vërtet po ballafaqohen me dita ditës. Është mirë që këtu e keni edhe përfaqësuesen e Qendrës për Punë Sociale e cila ballafaqohet si qendër ku është pikë kryesore për prezantimin e këtyre problemeve, qoftë nëpër gjykata, qoftë nëpër institucione tjera dhe për çdo ditë kemi numrin më të madh të këtyre rasteve. Mendoj që kontributi juaj do të na ndihmonte me të madhe që kjo strategji të merr formën e prerë dhe të kalojë edhe në kuvend, nëse, nuk e di tash Vitorja qysh e ka planifikuar, po mbi të gjitha nëse shkon në kuvend është mirë që me i parë edhe vërejtjet e publikut dhe të tjerëve. Mendoj që nëse sigurisht nga ju keni marr pjesë edhe në hartimin e këtij drafti do të kontribuoni edhe gjatë ditës së sotme me diskutimet e juaja.

Diçka më tepër, nëse ju e shihni që është e arsyeshme me trajtuar ndonjë kapitull të veçantë të këtij drafti, unë jam këtu dhe do t'i këqyrim bashkërisht, do t'i përpilojmë edhe ndonjë mungesë nëse ju mendoni që do të shtohet diçka nga kjo. Unë, nëse më kishit lejuar, që nga ky moment e kisha hapur debatin me ju. Nëse dëshiron dikush nga të pranishmit me marr fjalën, urdhëroni, faleminderit! Atëherë, ja kalojmë fjalën nënkryetares së komunës.

Marqe Tanushi-Selmanaj, nënkryetare e Komunës së Klinës: Faleminderit shumë, drejtor, ju përgëzoj për punën që e keni bërë! Një draft shumë i rëndësishëm që ka kohë që po mundohemi me i dhënë një epilog këtij drafti. Mirëpo, ne gjithë e dimë se këto janë procedurat që duhet me kaluar nëpër faza të ndryshme sikur kjo sot, dmth duhet dëgjim me publikun, mandej do të kalojë në seancë shpresoj, mirëpo, pasi që është draft, ne gjithë bashkë kemi mundësi me bërë ndryshime, kemi mundësi me shtuar ndonjë element ose siç e tha edhe drejtori që mund të heqim diçka nëse mendoni që nuk e ka vendin. Po diskutimi lidhur me këtë draft është pak problem për disa që nuk e kanë draftin, megjithatë, dhuna si dhunë nuk është një temë që ju nuk e dini, është temë që hasim çdo ditë, temë që prek gjitha gjinitë, temë që prek gjitha shoqëritë, nuk njeh moshë, nuk njeh gjini, thjesht nuk njeh as shoqëri, janë të përfshira pothuajse pjesa më e madhe e shoqërisë kudo që janë.

Edhe në komunën tonë si në shumë vende tjera, nga statistikat e ndryshme dhunë shohim çdo ditë, që po rritet numri, tani dilema është a rritet numri i dhunës në familje, a rritet numri i raportimeve, sido që të jetë edhe nëse është numri i raportimeve është diçka e mirë se masa po sensibilizohet. Përmes këtij drafti, kurdo që e shihni ndoshta në seancë ka me u prezantuar edhe ka me u parë më mirë se cilat janë planifikimet që janë bërë, dhe jam e sigurt që kishit pasur edhe kishit mundur të gjeni se çka me plotësuar.

Një element e di që e keni diskutuar shpesh me zyrtaren për Barazi Gjinore të cilën publikisht e përsëritet, znj. Vitore Shala, edhe Vitorja e sheh si problem takimet të cilat janë të planifikuara, dmth janë diku 4 takime të planifikuara dhe që e ka shumë të vështirë sikur sot, ta

sensibilizojë masën ose të gjejë diçka adekuate se çka duhet me punuar në plan. Ato 4 takime që janë të parapara, ato duan edhe buxhet, se edhe pjesa financiare është ajo që e ndihmon shumë një debat ose një temë, sepse normal që duhet së paku një ujë ose një kafe ose një diçka e ngjashme, çdo kund është e tillë, nuk është vetëm që ne e kërkojmë por çdo komunë i ka bërë këto kërkesa dhe jam shumë e sigurt që ishte dashur që të parashihet aty, ju e dini vet. Unë s'kam më shumë, faleminderit, drejtor!

Binak Sylaj, drejtor i Administratës: Faleminderit, nënkryetare!

E kemi diskutuar bashkërisht në grup, disa prej tyre mund të inkorporohen direkt dhe nga buxheti komunal që është i hartuar prej vitit të kaluar, po disa të tjerë e kemi diskutuar bashkë edhe me zyrtaren për Barazi Gjinore, e kemi planifikuar që çka mund të përfshijmë këtë vit, do ta ndajmë buxhetin me shtatorin e këtij viti për planifikim për vitin e ardhshëm 2025. Dmth jemi në hapa që mund ta arrijmë këtë edhe besoj që do ta gjejmë një gjuhë të përbashkët bashkë me kryetarin, për arsye se edhe kryetari është pjesë e këtij grupi, siç janë edhe institucionet tjera që i përmendëm edhe gjykatat edhe policinë edhe gjitha. Me vetë faktin që janë gjitha këto të inkorporuara, mendoj që kanë rëndësinë e vet në këtë strategji.

Është dashur të ballafaqohemi direkt edhe me qytetarët tjerë të gjitha moshave, të gjitha gjinive, po megjithatë, kjo situatë nuk është vetëm në komunën tonë, gjendja është nëpër krejt komunat e Kosovës. Ne ballafaqohemi bashkërisht edhe si institucion, e thash edhe më përpara, i dinë më së miri zyrtarët e Qendrës për Punë Sociale gjitha problematikat dhe llojet e tilla, këta ballafaqohen për çdo ditë me këso lloje problemesh edhe mendoj që janë më në ngjarje.

E dimë mirë sa ka shpenzime edhe për këtë që lypset edhe nga niveli lokal edhe nga niveli qendror të inkorporohen të gjitha mekanizmat, që mos të mbetet për buxhet për mos me mundur me realizuar një kërkesë të tillë, të një qytetari i cili ka probleme të llojit të tillë. Mendoj që do të ja dalim bashkërisht, kemi startuar mirë deri më tani, ashtu qysh e thash, mendoj që duhet të ndahet buxhet edhe për këto dhe faktikisht ne kemi ndarë edhe subvencione, e dini, ju jeni dëshmitarë të asaj dmth, prej problemeve të tilla kemi ndarë mjete, kemi kërkuar nga kryetari që nga subvencionet direkt nga zyra e tij me ndarë në këtë drejtim, mendoj që është arritur. Po ashtu, kemi edhe një marrëveshje që do të na ndihmojë pak edhe Shehria nëse s'gabo, se është e implikuar direkt Qendra për Punë Sociale, që ne ndajmë mjete dhe financojmë edhe Shtëpinë e Sigurt që është në Pejë. Kështu që, kjo është ajo që në kuadër të kësaj janë të parapara edhe ky buxhet që është mbi të gjitha, jemi zotuar që do të ndajmë buxhet shtesë. Po, Vlora?

Vlora Tafili, zyrtare për Informim: Përshëndetje për të gjithë! Përderisa po flasim te buxheti, Vitores ja kisha dhënë si rekomandim që planin e veprimit gjithqysh me vënë me buxhet, përndryshe kur na miratohet prej ministrisë, duke i pasur parasysh praktikat e tjera që i kemi me strategji, duke filluar prej strategjisë së Zyrës për Informim që e kam pasur dhe strategjinë për zhvillim ekonomik, që plani i veprimit nuk miratohet në qoftë se nuk i ka të parapara shumat edhe kjo është më e lehtë për ju pastaj, që kur të miratohet në kuvend, ju veç e keni kodin buxhetor të juaj edhe keni shumat buxhetore të përcaktuara.

Kam edhe një pyetje: kjo strategji, a është në përputhje me strategjinë kombëtare nacionale qysh për dhunë në familje dhe dhunë ndaj grave, që është e Qeverisë së Kosovës? Se ne duhet të shkojmë paralel dhe në harmoni me atë strategji të nivelit qendror.

Binak Sylaj, drejtor i Administratës: Po, Vlorë, faleminderit për kontributin! Mendoj që ke të drejtë plotësisht, por mbi të gjitha ky dokument është i harmonizuar me nivelin qendror, po ashtu, është i harmonizuar edhe me komuna tjera. Kështu që, mendoj që në këtë drejtim jemi në rregull me sa e di unë, për arsye se konsultat i kemi bërë bashkërisht disa herë.

Unë e thash edhe në fillim, kontributi është konkretisht i Vitorës, por mbi të gjitha është konsultuar me krejt grupin dhe mendoj që në këtë drejtim jemi në rregull edhe besoj që do të kalojë pa asnjë problem. Atëherë, ja kalojmë fjalën, znj. Nazife Qollakut.

Nazife Qollaku: Përshëndetje, pikë së pari ju përgëzoj për këtë draft se e keni miratuar!

Mirëpo, unë e kam një propozim: përveç mjeteve që janë afatshkurtra dhe afatmesme, të ketë një strategji edhe për afatgjata, ku p.sh., viktimat e dhunës në familje kalojnë nëpër faza shumë të vështira të jetës, pa marr parasysh nëse i paguhet p.sh., një qira ose kështu, kanë sfida shumë të rënda, saqë p.sh., përjetimet që kam pasur më herët, ne përjetojmë edhe disa brenga tjera, qoftë strehimit p.sh., të përkohshëm. Kisha pasur një propozim që të jetë një strategji për mundësi të strehimit të përhershëm ose më të gjatë nga komuna, se përjetimet janë shumë të rënda. Faleminderit!

Binak Sylaj, drejtor i Administratës: Faleminderit juve! Është e vërtetë që unë e prezantova në fillim, strategjia nuk është një vjeçare, nuk është një mujore, nuk është një vjetore, është strategji që hartohet për çdo periudhë. Periudhë kohore është 2024-2027 për momentin, edhe mendoj që është afatgjatë, nuk është e momentit. Pikërisht ai veprim që ju ka ndodhur në të kaluarën, që është dashur për momentin me vepruar edhe neve na ka obliguar edhe jemi detyruar që ta hartojmë këtë draft strategji, që do t'ia japim emrin draft rregullorë, që do të përfshijë këtë periudhë kohore, kështu që, kjo do të jetë e vazhdueshme edhe në të ardhmen.

Është një handikap këtu, që sigurisht e përmendi edhe nënkryetarja, edhe Vitorja është në dijeni, por ne bashkë me Vlorën e kemi prezantuar edhe nëpërmes ueb-faqes së komunës, pavarësisht ju a keni mundur ta hapni atë link apo jo, nuk e di, sigurisht nuk keni mundur edhe është krejt normale ajo që nuk e keni parë komplet edhe nuk e keni lexuar. Po ta kishit ju para vetës këtë strategji, sigurisht që kishit dhënë kontribut edhe më drejtpërdrejt.

Vlora Tafili, zyrtare për Informim: Po, kush është i interesuar, afat për dorëzim të komenteve ka deri më 11-tin, kështu që, mund t'i përcillni me imell tek unë ose edhe në formë fizike, në zarf edhe te komuna e Klinës në arkiv.

Binak Sylaj, drejtor i Administratës: Urdhëro, Shehrie Millaku?

Shehrie Millaku, përfaqësuese e Qendrës për Punë Sociale: Përshëndetje për të gjithë! Punoj në Qendër për Punë Sociale, udhëheqëse e shërbimit social, kryesisht punoj në referatin e punës për familjen.

Ky mekanizëm është një mekanizëm i cili defakto ka funksionuar edhe përpara, më vjen mirë që tash erdhi koha edhe në komunën tonë që ta kemi të shkruar si mekanizëm të cilët punojnë të gjithë akterët e rëndësishëm ku Qendra për Punë Sociale ka bashkëpunim të mirë. Gjithë ato që

janë cekur në këtë draft të cilat i kemi punuar së bashku me gjithë të tjerët, me anëtarët e grupit, janë prekur pikat kyçe të cilat për fillim uroj vetëm të gjitha të na miratohen, mirëpo nuk do të thotë që kjo tash sipas rasteve tjera të reja që do të vijnë e që nuk janë nuk do të ketë ndryshime, se me vetë faktin që do të tubohen nga 4 herë në vit, aty e kemi mundësinë që sipas rasteve t'i ndryshojmë edhe kërkesat, të shtojmë buxhet shtesë, gjitha këto hapësira i mbeten kohës. Pra, më tepër nuk kam çka të them, vetëm na shkoftë puna mbarë!

Binak Sylaj, drejtor i Administratës: Faleminderit, Shehrie! A ka dikush tjetër që dëshiron me u kyç në debat? Nëse jo, atëherë, siç e tha edhe Vlora, mund edhe në zarf t'i pranojmë komentet e juaja, nëse jo, atëherë mund ta hartojmë si të tillë.

Faleminderit për kontributin, unë diçka tjetër nuk kam, nëse keni edhe ju mos hezitoni. Faleminderit!

**Procesmbajtësja,
Monika Palushi**



**Zy. Kryesuesi,
Binak Sylaj**

